

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje mjete pastrimi”,

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
(detergjente) **39831200-8**

VLERA E FONDIT LIMIT: 10,333,333 (dhjetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e katër) **lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kamëz** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, , sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2020, 2021,2022** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit që prokurohet

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe i përmbahet rigorozisht parashikimeve

të nenit 43, pika 2/c, nenit 55, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, ku përcaktohet: “*Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave*”. Gjithashtu legjislacionit të fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës është brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në të paktën 1 (një) vit të *periudhës së kërkuar të viteve financiare*. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në Ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, në VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, në VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

2.2.2 Operatorët ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 3 vitet e fundit financiare (2020 – 2021-2022) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivitetit.

Shenim: Në respektim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, pika 4, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse dy bilancet e njëpasnjëshme nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

(Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë duhet të jetë **jo më e vogël se 40%** të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Si dëshmi për pervojën e mëparshme kërkohen:

- a) për pervojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për pervojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë pervojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi pervojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e objektit të kontratës duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 2 (dy)** persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumenti që duhet të paraqitet nga operatori ekonomik fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, është vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, gërma c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme, për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Gjykojmë se është e domosdoshme që operatorët ekonomikë të disponojnë një staf të mjaftueshëm prej 2 (dy) të punësuar, mbështetur në zërat e preventivit, natyrën e tyre dhe specifikimet teknike.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

(h)

Nr	Emri i mjetit	Sasi/Njësi	Statusi
1	Automjet (ATP) me masë maksimale të autorizuar jo më pak se 3.5 ton	1 copë	Pronësi ose me qera

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet që disponojnë, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara më sipër, të cilët duhet të disponojnë dokumentacionin si më poshtë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit:

- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë ne pronësi, të disponohet dokumenti që vërteton regjistrimin leje qarkullimi, taksa, çertifikata e kontrollit teknik, si dhe polica e sigurimit, të vlefshme të mjetit.*
- b) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë me qira, të disponohet kontrata e qirasë, dokumenti që vërteton regjistrimin leje qarkullimi, taksa, çertifikata e kontrollit teknik, si dhe polica e sigurimit, të vlefshme të mjetit.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet e nevojshme për të përmbushur dhe ekzekutimin me sukses të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim për të provuar kapacitetet teknike të OE të cilët do të angazhohen në plotësimin e kushteve të kontratës sipas preventivit (volumit të madh/sasisë së konsiderueshme) dhe specifikimeve teknike, në afatin e kërkuar. Mjetet e transportit me peshë maksimale të autorizuar jo më pak se 3.5 ton do të bëjë të mundur transportin e mallrave në vendin e caktuar, nisur nga fakti se malli do të shpërndahet nëpër shkollat dhe kopshtet që ndodhen në

territorin e Bashkise dhe ne Njesite e Bashkise duke rritur besueshmërinë e AK për përmbushjen me sukses të kontratës objekt i këtij prokurimi.

(Shënim- shtoni argumentimin nga ana teknike për nevojën për mjetet dhe pajisjet e kërkuara, për realizimin e kontratës).

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikata cilësie të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Çertifikatat që kërkohen duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe të përfshijnë objektin e prokurimit:

- **ISO 9001- 2015** ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë)
- **ISO 14001- 2015** ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor)

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nënin të 36 dhe 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, nenin 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit dhe siguron qëndrueshmërinë e produkteve, si dhe vlen në vazhdimësi për realizimin e kërkesave të AK nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemeve përkatëse.

Vendosja e çertifikatave të kërkuara më sipër është bërë mbështetur në specifikimet teknike. Është e nevojshme që operatorët ekonomikë të jenë të çertifikuar nga organizata kombëtare/ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit, sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi to. Këto standarde aplikohen për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar, pavarësisht nëse janë prodhuese apo importuese, madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë.

Vendosja e ISO 9001 na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, pra ky standard mundëson menaxhimin e cilësisë dhe vlerësimin e konformitetit duke siguruar kështu që mallrat të jenë të sigurta, të besueshme dhe të cilësisë së mirë.

Disponimi i ISO 14001 ose ekuivalent, nga ana e operatorëve minimizon ndikimin negativ në mjedis. Kjo lloj ISO na jep garanci që operatorët të ushtrojnë veprimtarinë në pajtueshmëri me ligjet për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit dhe ndihmon për parandalimin e rrezikut mjedisor. Pasi ka artikuj pastrimi që dëmtojnë ambjentin gjatë transportimit. Sqarojmë se mbrojtja mjedisore është një proces specifik i cili kërkon njohje të shumanëshme të natyrës, shkaqeve dhe çështjeve të veçanta të ndotjes së mjedisit dhe duhet të ketë njohuri lidhur me mënyrën se si menaxhohet një auditim mjedisor, njohuri të shumanëshme të mjedisit, metodikës etj.

2.4.2 Operatori ekonomik në rastet kur nuk është prodhues, duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose nga distributori i autorizuar i prodhuesit, për artikujt e kërkuar në shtojcën 6, përkatësisht me nr.rendor **1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12**. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota si, adresën e saktë të subjektit që e ka lëshuar këtë dokument, telefoni/e-mail/website, nënshkrimin dhe emrin e zyrtarit përgjegjës dhe vulën e subjektit, të nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.4.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë pranë AK-së në datën dhe orën e hapjes së ofertave nga një moster fizike për artikujt e kërkuar në shtojcën 6, përkatësisht me nr.rendor **1** deri në **12, 14, 21, 22, 29, 41, 42, 43, 44, 45**. Mosparaqitja e mostrave është kusht për skualifikim. Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në DT.

2.4.4.Operatori ekonomik duhet të deklarojë se, do të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, dëshmitë për rezultatet e testimit zyrtar për artikujt e kërkuar në shtojcën 6, përkatësisht me nr.rendor 1 deri 12, të lëshuara nga institucione të autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Argumentim: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenet 36 dhe 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/a/c, dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtyre kritereve kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë AK se mallrat që do të furnizojë do të jenë origjinale e cilësore, pra lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar i tyre në rastet kur nuk janë vet prodhues. Kështu autorizimi i prodhuesit apo distributorit të autorizuar, tregon nëse OE kanë mundësinë të ofrojnë mallra origjinale, në cilësi dhe me standarde ndërkombëtare, duke garantuar edhe gjatë periudhës së garancisë mbështetjen e kompanisë prodhuese/distributore gjatë procesit të furnizimit, me qëllim verifikimin e origjinës së mallrave dhe të dhënave të tjera të deklaruara. Nisur nga rëndësia që kanë artikujt me nr.rendor 1-12 të natyrës dizifektuese dhe që ndikojnë në mjedis dhe me vlerë të konsiderueshme, ka vendosur të kërkojë autorizimin e prodhuesit dhe rezultatet e testimit zyrtar për artikujt me nr.rendor 1-12, që të vërtetohet pajtueshmëria e artikujve objekt prokurimi me specifikimet teknike të kërkuara. Paraqitja e mostrave për artikujt e kërkuar në shtojcën 6, të cituar më sipër, është domosdoshmëri për të gjykuar nëse mallrat që do të ofrohen nga operatorët ekonomikë janë në përputhje të plotë me specifikimet teknike dhe operatori fitues, do të furnizojë me ato mallra identike që ka paraqitur ditën e tenderit dhe për të cilat do të jetë shpallur fitues. Janë përzgjedhur artikujt më të kërkuar, specifik të veçantë me rëndësi të natyrës dizifektuese dhe që ndikojnë në mjedis, me vlerë të konsiderueshme, ku skadenca dhe mirëfunksionimi i produktit ndikon në procesin e punës. Pra, me anë të këtyre kritereve ofertuesi garanton AK se mallrat që do të furnizojë, do të jenë sipas standarteve të njohura dhe testuara në treg dhe origjinale e cilësore.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në

*përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

- Garancia (skadenca) e mallrave do të jetë jo më pak se 1 vit, nga momenti i lëvrimin të tyre, mallrat e lëvruar do të jenë të njëjtë me mostrat e paraqitura ditën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.
- OE duhet të marrë përsipër të kryejë shërbimin e transportit të mallrave të furnizuara në të gjithë adresat e njësive të shkolla dhe kopshteve të AK.
- Nëse është përmendur ndonjë markë, është për efekt të saktësimin të llojit të pajisjes për të cilin kërkohet artikulli, i cili mund të jetë edhe ekuivalent, por gjithnjë duke plotësuar specifikimet e kërkuara nga AK.